



Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

Albanian National Olympic Committee

Rr. "Muhamet Gjollësia", Sheshi Mustafa Q. Atatürk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63
Tel: +355 4 2235 249 • E-mail: secretariat@nocalbania.org.al • <http://www.nocalbania.org.al>

NJOFTIM PËR POZICION VAKANT

“Operator/Kameraman”

Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH) është një organizatë sportive Kombëtare e pavarur, themeluar në vitin 1958, pa qëllim fitimi, e organizuar mbi bazën e parimeve të Kartës Olimpike, dhe që funksionon sipas statutit të saj. KOKSH është organizata e vetme që përfaqëson Lëvizjen Olimpik Shqiptare, parimet e së cilës janë të detyrueshme për tu zbatuar nga të gjithë anëtarët e saj.

Në kuadër të Projektit “**Ekipe Sportive 2022**”, projekt i financuar nga Buxheti i Shtetit, KOKSH, fton kandidatët e interesuar për të aplikuar për pozicionin e punës “**Kordinator Projekti**”

Objektivi i përgjithshëm i Projektit është krijimi i një Programi Kombëtar që nxit 1) sportin masiv, 2) zbulimin e talenteve, 3) edukatën sportive dhe parimet olimpike. Projekti do të formojë Ekipe sportive jashtë shkollore në nivelin 9-vjecar (nga klasa e 6 – 9); në nivelin shkollë e mesme (nga klasa 10 – 12); në universitete.

Detyrat e Operator/Kameraman

Operatori/kameramani do të përfshihet sipas direktivave në filmimet audio-vizuale në kuadër të projektit. Është përgjegjës për operimin e një sërë pajisjesh teknike, duke përfshirë kamera portative, kamera stand, montime celulare, mikrofon etj. Personi në fjalë do të bëjë filmimin e skenave, do të realizojë broadcast live, montimin dhe vendosjen e pajisjeve, përgatitjen e skenave, parapërgatitje si dhe cdo detyrë tjetër të deleguar nga supervizori. Për të përmbushur detyrat e caktuara Operatori/Kameramani duhet të ketë:

Kualifikimet dhe Eksperiencia:

- Të ketë përfunduar të paktën shkollën e mesme, arsimiti i lartë do të jetë plus.
- Eksperiencë të mëparshme të filmimeve në terren (5-10 vjet).
- Të ketë eksperiencë me xhirimet e spoteve promovionale.



Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

Albanian National Olympic Committee

Rr. "Muhamet Gjollësia", Sheshi Mustafa Q. Atatürk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63
Tel: +355 4 2235 249 • E-mail: secretariat@nocalbania.org.al • <http://www.nocalbania.org.al>

- Preferohet të ketë eksperiencë në xhirimin e aktiviteteve sportive.
- Njohja e gjuhëve të huaja (preferohet anglisht) do të përbëjë avantazh.

Aftësi dhe kompetenca kryesore

- Të ketë aftësi shumë të mira pune në grup.
- Të ketë njohuri të thelluara të rregullave të xhiritimit.
- Të njohë teknikat bashkekohore të xhiritimit.
- Njohuri mbi aparaturat broadcast / kamerat bashkekohore.
- Të zotërojë njohuri bazë të "Paketës Office".
- Aftësi bashkëpunuese në grup.

Procedura e aplikimit

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentat e aplikimit si më poshtë:

- Curriculum vitae (CV) në formatin Europass;
- Letër Interesi;
- Fotokopje të diplomave universitare;
- Dokumente të tjera mbështetëse (çertifikata të fituara nga trajnime, pjesëmarrje në konferenca, botime, letra reference, etj).

Kandidatët e interesuar duhet t'i dërgojnë dokumentet e aplikimit deri më datë 04 Maj 2022, ora 16.00, në adresën secretary.general@nocalbania.org.al, me subjekt: **Aplikim për pozicionin Kordinator Projekti "Ekipet Sportive 2022"**